



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
SPORTIT DHE RINISË
MINISTRI

Nr. 8830 Prot.

Tiranë më 20/09/2017

URDHËR

Nr. 418, datë 20.09.2017

**PËR
CAKTIMIN E DATËS SË FILLIMIT TË VITIT AKADEMIK 2017 - 2018 NË
INSTITUCIONET E ARSIMIT TË LARTË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 87 të ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë",

URDHËROJ:

1. Viti akademik 2017 - 2018 në institucionet e arsimit të lartë, të fillojë në datën 16 Tetor 2017 dhe të përfundojë në datën 30 Shtator 2018.
2. Periudha 25 Dhjetor 2017 deri në 5 Janar 2018, të jetë periudhë pushimesh për studentët.
3. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm, Drejtorja e Arsimit të Lartë dhe Shkencës në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Qendra e Shërbimeve Arsimore, si dhe institucionet e arsimit të lartë.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren Zyrtare".

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR

